



Kuvendi i Komunës

Nr. 001/06

Datë: 30.03.2011

Bazuar në Ligjin për Arsimin Fillor dhe të Mesëm neni 31.5, dhe Udhëzimit Administrativ 6/2010 të datës 11.05.2010, neni 6 pika 3.1.4 dhe Rregullores Komunale për të Drejtat, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Nxënësve të Shkollës së Mesme në Komunën e Junikut të datës: 29.10.2010, neni 12 pika ç) Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e mbajtur me datë 30.03.2011, bie ketë:

V E N D I M

Që nxënësit : Gentonis Maloku, Egzon Krasniqi, Aulon Hebibi, Metë Kasumi, Egzon Lllolluni, Miftar Gjota, Jeton Lllolluni, të kthehen në procesin e rregullt edukativo arsimor në Gjimnazi „Kuvendi i Junikut” në Junik.

Arsyetim

Nxënësit në fjalë kanë thyer rregullat e mirësjelljes në shkollë dhe njeherit kanë kryer vepër të rëndë penale nga neni 253, paragrafi 1), lidhur me nenin 15 dhe 23, të KPK. Me datë 02.03.2011, në Gjimnazi „Kuvendi i Junikut” në Junik, në bashkëpunim dhe në mënyrë të organizuar kanë thyer objektin shkollor, përkatësisht kanë thyer dyert e sallës së arsimtareve dhe të drejtorit, duke thyer ormanin e ditarëve në ç’rast kanë marrë ditarët e shkollës dhe shtëpizën e kompjuterit në zyrën e Drejtorit.

Qellim i kësaj vjedhje ishte eliminimi i të gjitha dokumenteve dhe dosjeve të cilat argumentojnë fakte për nxënësit në fjalë (eliminimi i mungesave të paarsyeshme) dhe njeherit pengimin e procesit edukativo arsimor dhe aftësues në Gjimnazin Kuvendi i Junikut në Junik.

Nxënësve në fjalë u janë shqiptuar të gjitha masat siç janë vërejtje gojore nga Kujdestari i klasës, largim nga shkolla për tri ditë nga procesi mësimor nga Drejtori i shkollës dhe njeherit largim nga shkolla për një muaj nga Drejtori i DKAS-së.

Meqenëse nxënësit nuk treguan përmirësim pas shqiptimit të këtyre masave Drejtoria e DKAS-së, në bazë të udhëzimeve ligjore këtë çështje e kaloi në Kuvend në mënyrë që të vendos për largim nga Gjimnazi „Kuvendi i Junikut” në Junik, apo arsim alternativ pa të drejtë rikthimi në shkollë. Ndërkaq Kuvendi pas shqyrtimit të rastit në fjalë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

I. Për zbatimin e këtij **Vendimi** do të kujdesen Kryesuesi i Kuvendit dhe Drejtoria për Arsim Kulturë Rini e Sport të Komunës së Junikut.

II. Ky **Vendim** hyn në fuqi ditën e miratimit, nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe marrjes së vërtetimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja.

III. Udhëzim juridik: Kundër këtij aktvendimi ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Sinan Gacaferi